Numër: 01-207 Datë: 01.04.2026

Në mbështetje të neneve 6,8,9 dhe 16 të Ligjit Nr.03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr.35/2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, Rregulloren Nr. 01/196 e punës së Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 31.03.2026 merr:

V E N D I M

I. **Refuzohet si e pa bazuar** ankesa Nr. prot. 01-107 datë: 29.01.2026, kunder vendimit të Këshillit Drejtues të AKK-së nr. prot. 10/01 datë: 05.01.2026.

II. **Korrigjohet** vendimi nr. prot. 10/01 datë: 05.01.2026 me të cili është vendosur për ankesën e Institucionit "Shoqata e Kontabilistëve të Certifikuar dhe Auditorëve të Kosovës" (ShKÇAK), Nr. prot. 01-606 datë: 18.08.2025 e ushtruar ndaj Vendimit të Këshillit Drejtues të AKK-së, me Nr. Prot.01-540 datë: 29.07.2025.

III. Ndryshohet këshilla juridike e vendimit si në paragrafin 1 ashtu që, pala ankuese udhëzohet që kundër vendimit të Këshillit Drejtues të AKK-së, Nr. prot. 10/01 datë: 05.01.2026 në afatin ligjor si palë e pa kënaqur mund ti drejtohet Gjykatës kompetente përmes konfliktit administrativ i cili mundet të hapet brenda afatit prej 30 ditësh nga pranimi i këtij vendimi sipas nenit 18 të Ligji nr. 08/l-182 për konfliktet administrative.

IV. Pjesa tjetër e vendimit nr. prot. 10/01 datë: 05.01.2026 mbetet në fuqi dhe e pa ndryshuar.

V. Ky vendim është përfundimtar në procedurën administrative brenda Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve.

A R S Y E T I M

Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (KD i AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 31.03.2026 shqyrtoi ankesën e paraqitur nga institucioni ShKÇAK lidhur me kufizimin e numrit të grupeve të trajnimit.

Pas shqyrtimit të ankesës, KD i AKK-së ka konstatuar se ankesa nuk është e bazuar në LPPA dhe se ka ardhur si pasojë e një gabimi teknik në këshillën juridike të vendimit Nr. Prot. 10/01 datë: 05.01.2026, ku në vend se ankuesi të udhëzohet për Gjykatë, është udhëzuar sërsih në ankesë ndaj aktit administrativ.

KD i AKK-së bazuar në nenin 50 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si organ vendimmarrës ka vendosur që të bëjë korrigjimin i gabimeve të dukshme në aktin administrativ përkatësisht vendimin nr. prot. 10/01 datë: 05.01.2026.

Bazuar në faktin se, sipas vendimit të korrigjuar KD i AKK-së kishte vendosur në mënyrë meritore, në këtë rast nuk është lëshuar në shqyrtimin e ankesës nr. prot. 01-107 datë: 29.01.2026, andaj dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.

Dr. Besim Mustafa
Kryetar i Këshillit Drejtues
Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve

Vendimi u dërgohet:

- "Shoqatës së Kontabilistëve të Certifikuar dhe Auditorëve të Kosovës" (ShKÇAK),
- Arkivit të AKK.